



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vendimi nr. 01/371 / Dt. 20/03 /2020

Në bazë të përgjegjësive nga Statuti i Përkohshëm i UKZ,

Mbas disa konsultimeve me prorektorët, dekanët, me stafin akademik, me studentët dhe administratën e UKZ-së,

Mbas konsultimit me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe në marrëveshje me Konferencën e Rektorëve të Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës,

Për shkak të përhapjes së pandemisë Covid 19 dhe vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërprerjen e procesit mësimor në territorin e Republikës,

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan,

Merr

V E N D I M

1. Procesi mësimor në UKZ, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha njësitë akademike, **vazhdon në format onlajn**, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e Përkohshëm të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.
2. Mësimi onlajn zhvillohet në platformat:
 - <https://meet.google.com/>
 - **E-learning (Moodle) të UKZ, <http://213.163.120.36/>**
3. Dekanët duhet të ndërmarrin të gjitha masat që stafi akademik dhe studentët të organizojnë ligjëratat dhe ushtrimet onlajn.
4. Stafi akademik dhe studentët duhet të organizojnë procesin mësimor rregullisht, në bazë të orarit mësimor dhe t'i kryejnë të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë në përputhje me ligjet në fuqi.
5. Stafi akademik dhe studentët mund të ndjekin Udhëzuesit për përdorimin e platformave për mësim onlajn, të cilat janë publikuar në ueb faqen e UKZ.
6. Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata duhet ta përshtasin punën e tyre në përkatje të mësimit onlajn.
7. Vendimi vlen deri në një vendim të ri.

Gjilan, më 20 mars 2020

Prof. Asoc. dr. Bajram Kosumi

